

FERIZAJ

An aerial photograph of the city of Ferizaj, Kosovo. In the foreground, a large mosque with a prominent white dome and minaret stands on the left, and a white church with a blue dome and arched windows is on the right. The city is densely packed with multi-story residential buildings in various colors. In the background, a range of mountains is visible under a clear blue sky with a few wispy clouds.

Udhëzues Turistik

Tourist information guide



Ky udhëzues turistik u ri-dizajnu në kuadër të projektit “Mbështetje në zhvillimin e turizmit përmes platformave interaktive”, nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit. Ky udhëzues turistik ka për qëllim të ofrojë informacione mbi potencialin turistik e kulturor të Komunës së Ferizajt.

Komuna e Ferizajt

Web: www.visit-ferizaj.com

E-mail: info@visit-ferizaj.com

Telefon: 03820046076

This tourist information guide has been implemented within the project “Support in the development of tourism through interactive platforms”, Directorate for Economic Development and Tourism.

This tourist information guide is intended to provide information on the tourist and cultural opportunities of the Municipality of Ferizaj.

Municipality of Ferizaj

Web: www.visit-ferizaj.com

E-mail: info@visit-ferizaj.com

Telephone: 03820046076



PËRMBAJTJA / CONTENT

Hartë turistike e Ferizajt / <i>Tourist map of Ferizaj</i>	6-7
Pozita gjeografike, relievi dhe klima / <i>Geographical position, relief and climate</i>	8-9
Historiku / <i>Background</i>	10-11
Popullsia / <i>Population</i>	12-13
Zhvillimi i qytetit / <i>City development</i>	14-15
Turizmi dhe Trashëgimia Kulturore / <i>Tourism and Cultural Heritage</i>	16-69
Festivale / <i>Festivals</i>	70-79

Fjala e Kryetarit të Komunës

Udhëzuesi Turistik i Komunës së Ferizajt, paraqet një hap të rëndësishëm në promovimin më të mirë të resurseve natyrore, ekonomike, kulturore e potencialit turistik të Komunës së Ferizajt. Si i tillë, ky dokument i punuar në detaje për të shpalosur sa më qartë e për t'i bërë sa më lehtë të qasshme për të interesuarit, resurset tona, është referencë e parë dhe kryesore e çdo vizitori të Ferizajt, të interesuar për ta njohur historinë, kulturën, zhvillimin ekonomik, bukuritë natyrore dhe pikat më të rëndësishme që përbëjnë boshtin e zhvillimit tërësor të Ferizajt.

Duke qenë kështu, Udhëzues Turistik i Komunës së Ferizajt është një nga dokumentet themelore që identifikon atë se çfarë në të vërtetë është Ferizaj, një qytet simbol i zhvillimit ekonomik, potencial i jashtëzakonshëm i turizmit dhe një mundësi më shumë si për qytetarët anembanë vendit, ashtu edhe për vendasit, bashkëqytetarët tonë ferizajas dhe natyrisht, vizitorët e bizneset e shumta vendore e të huaja.

Ferizaj, ka potencial të turizmit, reflektuar kjo në dy pikëpamje. E para që lidhet me pasuritë natyrore dhe monumentet në mbrojtje në të cilat institucionet lokale kanë ndërmarrë veprimet e mundshme për t'i ruajtur e promovuar, kësaj i shtojmë edhe peisazhin e jashtëzakonshëm, vargmalet që qarkojnë një pjesë të konsiderueshme të territorit të Ferizajt, me pikë reference fshatin Jezerc, të dëshmuar si një potencial zhvillimor e turistik, pa lënë anash edhe zonat tjera me potencial të jashtëzakonshëm turistik të paraqitura në formën e agroturizmit. Së dyti, pozita e favorshme gjeografike, dinamikat e zhvillimit ekonomik, frekuentimi masiv nga qendra të tjera të afërta brenda dhe jashtë vendit, historia e zhvillimit të qytetit, diversiteti kulturor e etnik, mosha e re e popullatës dhe dallueshmëria mes komunave tjera në fushën e ndërmarrësisë, janë disa nga pikënisjet që reflektojnë potencialin turistik të Komunës së Ferizajt e që suksesshëm i vihen kornizat dhe orientimet në këtë udhëzues turistik.

Tashmë, vizitorët si nga jashtë apo edhe nga brenda Kosovës, përmes këtij Udhëzuesi Turistik, do ta kenë më të lehtë, të orientohen, t'i qasen e t'i njohin nga afër resurset tona, që bëjnë Ferizajn, një qendër të rëndësishme, të dalluar me veçantitë e tij, me potenciale të shumëllojshme në gjithë gjeografinë kombëtare.

Me respekt,

Agim Aliu

Kryetar i Komunës së Ferizajt

Speech of the Mayor of the Municipality


The Tourist Information Guide of the Municipality of Ferizaj represents an important step in the best promotion of the natural, economic, and cultural resources, as well as the tourist potential of the Municipality of Ferizaj. As such, having been prepared in detail in order to reveal as vividly as possible and not only make our resources easily accessible to those who are interested, but to serve as a main reference every visitor interested in getting to know the history, the diverse culture, economic development, natural beauty, and the most important sites that Ferizaj offers.

That being the case, this Tourist Information Guide of the Municipality of Ferizaj is one of the basic documents that identifies what Ferizaj really stands for - a city, a symbol of economic development, of tremendous tourism potential, and rather, it represents one more tourist option for citizens across the country, as well as for the locals - our fellow Ferizaj citizens - and, of course, for many foreign visitors and many local and foreign businesses.

Ferizaj has the tourism potential which is reflected in two points of view. The first one is related to the natural assets and monuments in which the local institutions have already undertaken actions for their preservation and promotion. This is also diversified with the extraordinary landscape, the mountain ranges that surround a significant part of the territory of Ferizaj - with a reference point being the village of Jezerc which has proved to be a potential for development of tourism, without leaving aside other areas with extraordinary tourist potential presented in the form of agrotourism. Secondly, the favourable geographical position, the dynamics of economic development, mass visitors from other nearby centers inside and outside the country, the history of the city's development, the cultural and ethnic diversity, the young age of the population and the distinction from other municipalities with regards to entrepreneurship, are just some of the starting points that reflect the tourist potential of the Municipality of Ferizaj and which have successfully been presented and introduced in this tourist guide.

Now, having this Tourist Information Guide available, visitors from both outside and inside Kosovo will find it easier to orient themselves, to access and get to closely know sites which make Ferizaj an important center, distinguished by its peculiarities and its diverse potentials throughout the national geography.

*Best regards,
Agim Aliu
Mayor of Ferizaj Municipality*




Shpjegues

- | | |
|------------------------------------|---|
| 1 Parku i Lirisë | 13 Xhamia dhe Kisha |
| 2 Kazerma e FSK-së | 14 Sheshi "Ramadan Rexhepi" |
| 3 Mulliri i Madh | 15 Biblioteka "Sadik Tafarshiku" |
| 4 Bifurkacioni i Lumit Neredime | 16 Sheshi "Hyrë Emini" |
| 5 Mulliri i Nikës | 17 Murali i Kamarierit |
| 6 Pallati i Sportit "Bill Clinton" | 18 Sheshi "Adem Jashari" |
| 7 Muzeu dhe Galeria | 19 Stacioni i Trenit |
| 8 Ish-Konvikti | 20 Arkivi |
| 9 Ish-Gjimnazi "Ismail Qemali" | 21 Stacioni i Autobusëve |
| 10 Shkolla "Jeronim De Rada" | 22 Kisha Katolike |
| 11 Teatri "Adriana Abdullahu" | 23 Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj |
| 12 Qendër Tregtare | |

Legend

- | | |
|------------------------------------|---|
| 1 Liberty Park | 13 Mosque and Church |
| 2 Barrack of KSF | 14 Square "Ramadan Rexhepi" |
| 3 The Great Mill | 15 Library "Sadik Tafarshiku" |
| 4 Bifurcation of River Neredime | 16 Square "Hyrë Emiri" |
| 5 Nika's Mill | 17 Mural of the Waiter |
| 6 Sport Hall "Bill Clinton" | 18 Square "Adem Jashari" |
| 7 Museum and Gallery | 19 Train Station |
| 8 Former Dormitory | 20 Archive |
| 9 Former Gymnasium "Ismail Qemali" | 21 Bus Station |
| 10 School "Jeronim De Rada" | 22 The Catholic Church |
| 11 Theatre "Adriana Abdullahu" | 23 University of Applied Science in Ferizaj |
| 12 Shopping Center | |



POZITA GJEOGRAFIKE, RELIEVI DHE KLIMA

Komuna e Ferizajt ka një sipërfaqe prej 345 km², e cila shtrihet në pjesën jugore të Kosovës dhe në pjesën veri-lindore të maleve të Sharrit. Në lindje kufizohet me Komunën e Gjilanit dhe të Vitisë, në jug kufizohet me Komunën e Kaçanikut (16 km), në jugperëndim me Shtërpçën (32 km), në perëndim me Prizrenin (60 km) e Therandën (42 km) dhe në veri me Shtimën (13km) e Lipjanin (17km). Distanca e Ferizajt nga kryeqendra e Kosovës, Prishtina është 36 km, kurse nga Shkupi 48 km.

Qyteti i Ferizajt ka pozitë qendrore ndaj territorit të komunës, ku lartësia mbidetare e qytetit është rreth 580 metra mbi nivelin e detit. Ferizaj ka një pozitë shumë të mirë gjeografike, duke qenë se shtrihet në pjesën ku janë kryqezuar rrugët e vjetra Prizren - Anamoravë dhe rruga Prishtinë - Shkup.

Pjesa më e madhe e sipërfaqeve të Komunës janë rrafshina me 44.53 %, nga ana jugperëndimore 10.98 %, dhe ana lindore 4.03 %, ndërsa pjesa veriore është kryesisht në terrene të larta rreth 5.78 %, ajo verilindore 7.96%, dhe veriperëndimore 6.71%. Qyteti ka lartësi mbi detare rreth 580 metra mbi nivelin e detit dhe ka një reliev të rrafshët. Relievi në qytet mundëson një planifikim dhe zhvillim shumë të mirë të infrastrukturës për transport. Lumi më i madh Neredime përshkon tërë territorin e komunës.

Ferizaj karakterizohet me klimë kontinentale, sikurse pjesa më e madhe e Rrafshit të Kosovës. Temperatura vjetore mesatare është 10°C. Muajt më të ngrohtë janë Korriku dhe Gushti, me temperaturë mesatare 18.9°C. Muaji më i ftohtë është Janari, me temperaturë mesatare -2.6°C.




GEOGRAPHICAL POSITION, RELIEF AND CLIMATE

The municipality of Ferizaj covers an area of 345 km² and is situated in the southern part of Kosovo and in the north-eastern part of the Sharri mountains. In the east it is bordered by the Municipalities of Gjilan and Vitia, in the south by the Municipality of Kaçanik (16 km) in the south west by Shterpçë (32 km) in the west by Prizren (60 km) and Theranda (42 km) and in the north by Shtime (13km) and Lipjan (17km). The distance of Ferizaj from the capital of Kosovo, Prishtina, is 36 km and from Skopje is 48 km.

The city of Ferizaj occupies the central position in the territory of the municipality with an altitude of around 580 meters above sea level. Ferizaj is characterized by its favourable geographical position as it lies in the old Prizren-Anamorava and Prishtina-Skopje crossroads.

44.53% of the municipal area is plain, namely 10.98% in the south-west side, 4.03% in the east side, while the northern part is mainly on high ground around 5.78%, the northeast 7.96%, and in the north-west 6.71%. The city is situated around 580 meters above sea level and has a plain relief. The city relief enables a very good planning and development of the transport infrastructure. The largest river, Nerodime, crosses the entire territory of the municipality.

Ferizaj is characterized by a continental climate, like most of the Kosovo Plain. The average annual temperature is 10°C. The warmest months are July and August, with an average temperature of 18.9°C. The coldest month is January, with an average temperature of -2.6°C.



HISTORIKU

Ferizaj është qytet i ri, por rrethina e tij ka qenë e banuar që nga mijëvjeçari VI p.e.s. Nga gjetjet arkeologjike në fshatin Varosh, 3 km në jug të Ferizajt, dëshmohej se këto anë kishte një qytetërim që në kohën e neolitit të hershëm. Andaj, nga shekulli VIII para Krishtit e deri në pushtimin romak, Ferizaj dhe rrethina e tij u banua nga popullata dardane. Tumat varrore dardane janë gjetur në rajonin e Ferizajt, në Gerlicë (Gurez) gjithsej 18 varreza, të cilat i përkasin shekujve VIII-VII, dhe më pas nekropolet tumulare në Zaskok.

Ferizaj zë fill më 1873 me ndërtimin e hekurudhës Mitrovicë - Shkup. Në pjesën e dytë të shekullit XIX, udhëpërshkruesit flasin për Hanin e Feriz Bej Shasivarit, sipas të cilit e mori emrin ky vendbanim, që brenda pak dekadash u bë qytet, i populluar kryesisht nga tregtarë e zejtarë. Si emër i parë i vendbanimit të ri ishte i emërtuar në shënimet e kohës si Ferizoviq. Nga viti 1874, krahas këtij emri, që ishte emërtuar nga autoritetet e kohës ishte në përdorim edhe emri Tasjan që nga gjuha frënge kemi të bëjmë me stacion.



BACKGROUND



Ferizaj is a new city, but its surroundings have been inhabited since the 6th millennium BC. From the archaeological findings in the village of Varosh, 3 km in south of Ferizaj, it is proved that there was a civilization in these parts since the time of the early Neolithic. Thus, from the 8th century BC until the Roman Conquest, Ferizaj and its surroundings were inhabited by the Dardanian population. The Dardanian burial mounds were found in the region of Ferizaj, in Gerlica (Gurez) in total of 18 cemeteries that belong to the VIII-VII centuries, and then then the tumular necropolis in Zaskok.

Ferizaj was founded in 1873 with the construction of the Mitrovica - Skopje railway. In the second half of the 19th century, travellers talked about the inn of Feriz Bey Shasivari, after whom this settlement was named, and within a few decades it became a city, populated mainly by merchants and craftsmen. As the first name of the new settlement, it was named in the records of the time as Ferizovic. Since 1874, in addition to this name which was established by the authorities of the time, the name Tasjan was also in use, which derived from the French word station.





POPULLSIA

Bazuar në regjistrin e popullsisë të vitit 2011, Komuna e Ferizajt ka 108,690 banorë. Rreth gjysma e tyre jetojnë të shpërndarë në 44 fshatrat e saj. Përveç popullsisë shqiptare, rreth 2,06 % e popullsisë është e nacionaliteteve tjera si ashkalinjë, romë, goranë, serbë.

Sa i përket përkatësisë religjioze, në Komunën e Ferizajt dominon përkatësia religjioze myslimane, që përbën 98.63% të numrit të përgjithshëm të banorëve. Komuniteti i dytë më i madh religjioz është ai katolik, ortodoks, dhe protestant.

POPULATION

Based on the 2011 population census, the Municipality of Ferizaj has 108,690 inhabitants - about half of them living in its 44 villages. In addition to the Albanian population, about 2.06% of the population is of other nationalities, such as Ashkali, Roma, Gorani and Serbs.

Regarding religious affiliation, the Muslim religious affiliation dominates in the Municipality of Ferizaj this constituting 98.63% of the total number of inhabitants. The second largest religious community is the Catholic, Orthodox and Protestant.

ZHVILLIMI I QYTETIT

Krahasuar me qytetet tjera, Ferizaj është njëra prej qendrave urbane më të reja të Kosovës. Si vendbanim, ai është formuar në periudhën osmane. Pas vitit 1873, u zhvillua në një qytet përgjatë vijës hekurudhore Mitrovicë - Shkup. Kjo vijë hekurudhore kishte rëndësi shumë të madhe për transportin e udhetarëve dhe të mallrave.

Zhvillimi i qytetit mori hov pas vitit 1900. Në këtë periudhë fillojnë të zhvillohen disa veprimtari, si ato zejtare dhe tregtare. Veprimtari dominuese në qytet ishte tregtia. Në vitin 1900, prej 400 shtëpive sa kishte gjithsej Ferizaj, 200 ishin dyqane tregtare dhe zejtare.

Gjatë periudhës në mes të dy luftërave botërore, qyteti i Ferizajt nis të zhvillohet. Nga ajo kohë, ende ka disa objekte të mbetura, si Shtëpia e Kulturës “Hivzi Sylejmani” (tani Teatri “Adriana”), e ndërtuar në vitin 1924 dhe Biblioteka (Tani Arkivi Historik) e ndërtuar në vitin 1928. Por zhvillimi ekonomik nuk ishte në nivelin e duhur, kjo bëri që nga kjo periudhë të kemi të vetmën ndërmarrje në Ferizaj e cila ishte Fabrika e Tjegullave. Kurse ndërmarrjet dhe fabrikat e tjera janë formuar pas Luftës së Dytë Botërore, ku vlen të përmenden Fabrika Tubave, Vegëltorja, Kombinati i Drurit, Fabrika e Ujtive, Fabrika e Vajit, Fabrika e Bukës, Fabrika e produkteve ushqimore “Minex” etj. Kjo ka bërë, që Ferizaj të zhvillohet duke u bërë njëra ndër qendrat më të mëdha industriale dhe tregtare të Kosovës, falë edhe pozitës së volitshme gjeografike që ka Ferizaj i ndodhur në mes të dy kryeqyteteve, Prishtinës dhe Shkupit si dhe të ndërtimit të vijës hekurudhore. Andaj kjo ka bërë që në ditët e sotme Ferizaj është qytet me një numër të madh bizneseve të cilat kanë ndikuar në ngritjen e mirëqenies dhe të ardhurave për ferizajasit.



CITY DEVELOPMENT

Compared to other cities, Ferizaj is one of the newest urban centers of Kosovo. As a settlement, it was formed during the Ottoman period. After 1873, it was developed into a town along the Mitrovica - Skopje railway line. This railway line was very important for the transportation of passengers and goods.

The development of the city took off after 1900. In this period, some activities, such as crafts and trade, began to develop. The dominant activity in the city was trade. In 1900, out of 400 houses in Ferizaj, 200 were commercial and handicraft shops.

The city of Ferizaj began to develop during the period between the two world wars. From that time, there are still some remaining objects, such as the Culture House "Hivzi Sylejmani" (now the Theater "Adriana"), built in 1924 and the Library (now the Historical Archive) built in 1928. However, the economic development was not at the right level, this meant that the only enterprise in Ferizaj during this period of time was the Tile Factory. Where as other enterprises and factories were developed after the Second World War, where it is worth mentioning the Pipe Factory, the Tool Factory, the Wood Factory, the Water Factory, the Oil Factory, the Bread Factory, the "Minex" Food Products Factory, etc. Given the favourable geographical position of Ferizaj located between the two capitals, Pristina and Skopje has made Ferizaj becoming one of the largest industrial and commercial centers of Kosovo, as well as the construction of the railway line. Therefore, this has led to the fact that nowadays Ferizaj is a city with a large number of businesses that have influenced in the increase of the well-being and created more incomes for residents of Ferizaj.



TURIZMI DHE TRASHËGIMIA KULTURORE

Ferizaj si qytet është i ri, por fshatrat përreth tij kanë qenë të banuar që nga kohët e lashta dhe për këtë ka dëshmi e gjetje të shumta. Hulumtimet e herë pas hershme janë bërë, si në Varosh, Komogllavë, Jezerc, Neredime e vende të tjera dhe nga arkeolog e etnograf është thënë se rrethina e Ferizajt ka një potencial të madh të objekteve me vlerë nga lashtësia.

Ekzistojnë disa lokacione që janë pjesë e trashëgimisë kulturore, ndër këto duhet veçuar Kishën Dardane në malet midis fshatrave Komogllavë, Sojevë e Fshat i Vjetër, ujësjellësi i kohës Ilire-Romake në fshatin Komogllavë, që furnizon me ujë të pijes edhe sot disa familje, tumat (varrezat) Ilire në fshatin Varosh, mulliri i Nikës, ende në funksion, që nga viti 1321, mbetjet e qytetit të vjetër në Jezerc, gërmadha të kohëve të ndryshme në Neredime etj.

TOURISM AND CULTURAL HERITAGE

Ferizaj as a city is new, but the villages around it have been inhabited since ancient times and there are many evidences and findings for this. Many researches have been conducted from time to time, such as in Varosh, Komogllavë, Jezerc, Neredime and other places, and archaeologists and ethnographers have said that the surroundings of Ferizaj have a great potential of valuable objects since antiquity.

There are several locations that are part of the cultural heritage, among which the Dardane Church in the mountains among the villages of Komogllavë, Sojevë and Fshat i Vjetër, the Illyrian-Roman aqueduct in the village of Komogllavë, which supplies drinking water even today to several families, the Illyrian mounds (cemetery) in the village of Varosh, the mill of Nika, still in operation, since 1321, and the remains of the old town in Jezerc, ruins in Neredime, etc.



KISHA PALEOKRISTIANE NË NIKADIN

PALEOCHRISTIAN CHURCH IN NIKADIN

Gjatë viteve '60-të të shekullit XX, në fshatin Nikadin janë evidentuar gjurmë sipërfaqësore të mbase ndonjë kompleksi të vilave romake ku u zbulua një artefakt shumë i rrallë dhe mbase unik për trevën e Kosovës. Kemi të bëjmë me një kapak sarkofagu (sarcophagus - arkivol apo arkë për vendosjen e kufomës), terësisht nga guri gëlqeror i mermerizuar në trajtë të çatisë së shtëpisë, ku dominojnë dekoret me motive antropomorfe (figurë

njeriu) në akse dhe motive floreale në front. Ky kapak sarkofagu i përket periudhës romake të fundit të shekullit III e.s. dhe fillimi i shekullit të IV e.s. Në vendin ku është gjetur kapaku i sarkofagut, janë zhvilluar disa sondazhe arkeologjike (2007) që rezultuan me gjurmë të një kisha me përmasa jo të mëdha, ndonëse mjaft e dëmtuar, e periudhës së krishterimit të hershëm (shekujt IV-VII e.s.), e plotësuar me disa spolje (material i ripërdorur) të plastikës dekorative sepulkrare të periudhës romake (shekujt III-IV e.s.).



Kapaket e Sarkofagut Në Nikadin


During the 60s of the 20th century, in the village of Nikadin, surface traces of perhaps a complex of Roman villas were found, where a very rare and unique artefact for the territory of Kosovo was discovered. We are talking about a sarcophagus lid (sarcophagus - coffin or box for placing the corpse), made entirely of marbleized lime stone in the shape of the roof of the house, and dominated by decorations with anthropomorphic motifs (human figures) on the axes and floral motifs on the front. This sarcophagus lid belongs to the late Roman period of the 3rd century

AD and the beginning of the 4th century AD. Several archaeological researches were conducted (2007) in the place where the lid of the sarcophagus was found, which

resulted in traces of a church of not-so large dimensions, although quite damaged, from the early Christian period (IV-VII centuries AD), and completed with some stelae (recycled material) of decorative sepulchral plastic from the Roman period (III-IV centuries AD).

MOZAIKU NË NERODIME E POSHTME

Në vitin 1988, në fshatin Neredime e Poshtme, e cila ndodhet në perëndim të qytetit të Ferizajt, disa sondazhe arkeologjike të zhvilluara këtu në arealin fare pranë varreve ortodokse, rezultuan me zbulimin e një kompleksi prej një vile të antikës së vonë, me atrium dhe mozaik polikromi, gjeometrik dhe figural i dyshemesë. Faza e parë i përket shekullit IV, kurse rindërtimi dhe mbindërtimi i takon shekullit V-VI. Mozaiku u zbulua në dyshemenë e një dhome drejtkëndore me absidë, mbase që ka shërbyer si triklinijum. Ky mozaik është grabitur nga pushtuesit serb dhe gjendet në Serbi.





MOSAIC IN NERODIME E POSHTME

In 1988, several archaeological surveys were carried out in the village of Nerodime e Poshtme, located to the west of the city of Ferizaj, in the area very close to the Orthodox graves, and they resulted in the discovery of a complex of a late antique villa, with an atrium and a mosaic polychrome, geometric and figural floor. The first phase belongs to the 4th century, whereas the reconstruction and superstructure belong to the V-VI century. The mosaic was discovered on the floor of a rectangular room with an apse which may have served as a triclinium. This mosaic was looted by the Serbian invaders and is located in Serbia.

“MALI I KISHËS” NË KOMOGLLAVË

Bëhet fjalë për një kishë ilire-dardane e ngrehur në një lartësi mbidetare prej 600 metrash, e cila mendohet të ketë qenë një e objekt ku janë kryer shërbesat fetare kishtarë për disa fshatra. Dalja në sipërfaqe kësaj kishë dhe bashkë me të dhe fragmente tjera, dokumentojnë ekzistencën e jetës në këtë vend. Në këtë lokalitet janë gjetur vazo, enë prej qeramike, monedha, stoli, gjësende hekuri dhe lëndë të tjera të karbonizuara, por edhe gurë karakteristik.

Kjo kishë besohet se duhet t'i takoj shekullit të IV-V e.s., por që është rindërtuar në periudhën e mesjetës në kohën e perandorisë bizantine. Është një lokalitet antik i urbanizuar me rrugë, kanalizim dhe infrastrukture tjetër. Poçaria e gjetur këtu pak ngjason me ato që janë gjetur në vendbanime tjera. Këto enë të qeramikës dhe kryqi i kishës gjenden në muzeun e qytetit në Ferizaj.



KROI I PERIUDHËS ILIRO-ROMAKE



Kroi i periudhës iliro-romake ndodhet në fshatin Komogllavë dhe është vendosur në periudhën para romake, duke qenë se romakët për sistemet e ujësjellësit përdornin më së shumti gypa prej plumbi. Në fakt, gjurmët e vendbanimit antik hasen në të gjitha anët e fshatit, sepse aty mund të gjenden shtresa hiri, blözë por edhe pjesë të enëve nga qeramika, të cilat, bazuar në formën dhe përbërjen e tyre, mendohet se i takojnë poçerisë vendase (dardane) të Antikës së vonshme. Pjesë nga tubat e kroit aktualisht ndodhen në muzeun e qytetit.

"MOUNTAIN OF THE CHURCH" IN KOMOGLlavë

THE FOUNTAIN OF THE ILLYRIAN-ROMAN PERIOD




The Fountain of the Illyrian-Roman period is located in the village of Komogllavë and was placed in the pre-Roman period, since the Romans mostly used lead pipes for water supply systems. In fact, the traces of the ancient settlement can be found in all parts of the village, because there you can find layers of ash, soot, but also parts of ceramic vessels which, given their shape and composition, are thought to belong to the local pottery (Dardanian) of Late Antiquity. Parts of the fountain pipes are currently in the city museum.



This is an Illyrian-Dardanian church erected at an altitude of 600 meters above sea level, which is thought to have been a place where church religious services were offered for several villages.

The discovery of this church and other fragments thereby, document the existence of life in this place. Vases, ceramic vessels, coins, ornaments, iron objects and other carbonized materials, as well as characteristic stones, were found in this locality. This church is believed to date back to the 4th - 5th century AD, but it was rebuilt in the Middle Ages during the Byzantine Empire. It is an ancient urbanized locality with different roads, sewerage and infrastructure. The pottery found here bears little resemblance to those found in other settlements. These pottery vessels and the church cross are preserved in the city museum in Ferizaj.



KALAJA E JEZERCIT

Ky lokalitet arkeologjik në literaturën e mëhershme njihet si Kalaja e “Pjetrit”, kurse nga banorët e fshatit dhe nga të dhënat të tjera del se ky toponim njihet gjerësisht si “Kalaja e madhe”. Kalaja ndodhet në anën e djathtë të rrjedhës së lumit Neredime, përkatësisht në afërsi të bashkimit të lumenjve. Po ashtu, kalaja ndodhet afër kishës paleokristiane (shek. IV-V). Kalaja e Jezercit është njëri nga monumentet e rëndësishme të trashëgimisë kulturore e historike në Ferizaj.



THE CASTLE OF JEZERC

In the old literature this archaeological site was known as “Peter’s” castle, while from the local residents and from other data as well, it appears that this toponym was generally known as “the big castle”. The castle is located on the right side of the Neredime river, near the confluence of the rivers. Also, the castle is located close to the Paleo-Christian church {IV-V century). The Castle of Jezerc is one of the important monuments of cultural and historical heritage in Ferizaj.



**BIBLIOTEKA PUBLIKE
“SADIK TAFARSHIKU”
“SADIK TAFARSHIKU”
PUBLIC LIBRARY**



Objekti i bibliotekës është ndërtuar me 1908 duke hyrë në mesin e ndërtesave më të vjetra publike në qytetin e Ferizajt. Në të kaluarën kishte shërbyer si Komunë, më pas Ent Pedagogjik, kurse për një kohë bodrumi i saj kishte shërbyer edhe si burg, ku vuajtën dënime dhe maltretime të rënda shumë banorë të kësaj ane nga ana pushtetit ushtarako-policor serb. Pas luftës së fundit të Kosovës (1998-1999) ky objekt u shndërrua në Bibliotekë. Arkitektura e këtij objekti ka një strukturë të përbërë kryesisht nga ndikimi dhe gërshetimi i kulturave austriake dhe asaj të orientit.

The building of the library was built in 1908, being among the oldest public buildings in the city of Ferizaj. In the past it served as a Municipality, then as a Pedagogical Entity, and for a while its basement also served as a prison, where many residents suffered severe punishment and mistreatment by the Serbian military-police authorities. After the last war in Kosovo (1998-1999), this building was converted into a Library. The architecture of this building has a structure mainly composed of the influence and interweaving of Austrian and Eastern cultures.



TEATRI I QYTETIT

“ADRIANA ABDULLAHU”

CITY
THEATRE
“ADRIANA ABDULLAHU”

Teatri i Qytetit në Ferizaj ka filluar të ndërtohet në vitin 1924 dhe ka përfunduar në vitin 1927. Në fillim kishte shërbyer si qendër gjimnastikore. Nga viti 1943, ky objekti fillon të përdoret për teatrin amator të Ferizajt. Themelues i Teatrit ka qenë Hasan Dyngjeri. Ky teatër ka pasur një numër të konsiderueshëm shfaqjesh të zhan reve të ndryshme të dramaturgjisë. Në vitin 2007 teatri u shndërrua nga një teatër amator në atë profesional, dhe mori emrin “Adriana Abdullahu”. Teatri “Adriana Abdullahu” ka një veprimtari e kontribut të pasur në artin dramatik kombëtar, duke qenë për mbi 50 vite, që nga viti 1970, organizatore e Festivalit më të madh mbarëkombëtar të teatrove.

The City Theatre in Ferizaj began to be built in 1924 and was completed in 1927. At first it served as a gymnastics centre. From 1943, this facility began to be used for the amateur theatre of Ferizaj. The founder of the theatre was Hasan Dyngjeri. This theatre has had a considerable number of performances of different genres of dramaturgy. In 2007, the theatre changed from an amateur theatre into a professional one, and took the name “Adriana Abdullahu”. Theater “Adriana Abdullahu” has a rich activity and contribution to the national dramatic art, being for over 50 years, since 1970, the organizer of the largest nationwide Theater Festival.



GALERIA E ARTEVE

ART GALLERY

Galeria e Arteve në Ferizaj është themeluar në vitin 2010 me vendim të Kuvendit Komunal të Ferizajt. Kjo Galeri ka për synim të prezantojë dhe të promovojë artet pamore, siç janë: piktura, skulptura, grafitet, dizajni, arkitektura, instalacionet dhe zhanre tjera të arteve pamore. Galeria e Arteve “Ismail Rama” ka një aktivitet të mbushur me ekspozita, rekuizita, punëtori, trajnime për artistë të rinj, etj. Për 12 vite ka realizuar rreth 70 ekspozita kolektive, kombëtare dhe ndërkombëtare me pjesëmarrje të artistëve nga shumë vende të botës, po ashtu edhe rreth 30 ekspozita individuale. Duke pasur një agjendë të ngjeshur me ngjarje jubilarë, siç është ekspozita kolektive tradicionale për 17 Shkurt - ditën e Pavarësisë së Kosovës dhe ndarja e çmimit “Gursel Sylejmani”, më pas Bienali i vizatimit, Ditët e Kulturës, Ditët e Diasporës, Bienali i Skulpturës, Festivali i Karikaturës, Ekspozita e Fotografisë, është bërë njëra prej Galerive më së shumti aktivitetete në vend.

The Art Gallery in Ferizaj was founded in 2010 by the decision of the Municipal Assembly of Ferizaj. The Gallery aims to present and promote visual arts, such as: paintings, sculptures, graffiti, design, architecture, installations and other genres of visual arts. “Ismail Rama” Art Gallery has an activity full of exhibitions, props, workshops, training for young artists, etc. For 12 years, it has realized about 70 collective, national and international exhibitions with the participation of artists from many countries of the world, as well as about 30 individual exhibitions. Having a busy agenda with jubilee events, such as the traditional collective exhibition for February 17 - the day of Kosovo’s Independence and the awarding of the “Gursel Sylejmani” award, then the Drawing Biennial, Culture Days, Diaspora Days, Sculpture Biennial, the Caricature Festival, the Photography Exhibition, has become one of the most active Galleries in the country.



ARKIVI I FERIZAJT

FERIZAJ ARCHIVE

Objekti i Arkivit është ndërtuar në vitin 1928, ku gjatë periudhave të ndryshme historike është përdorur për funksione të ndryshme, si p.sh. stacion i sigurimit shtetëror. Objekti ka qenë në posedim privat deri në vitin 1947, atëherë kur shteti e pronëson.

Arkivi Historik i qytetit të Ferizajt është themeluar më 19.04.1980 me vendim të Kuvendit Komunal, por puna si njësi kulturore ka filluar nga data 01.09.1980. Gjithsej kishte 199 regjistratura të komunës.

Tani Arkivi Historik përfshin qytetin e Ferizajt me rrethin dhe vepron në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport. Përmban 68 fonde të veprimtarive të ndryshme (urbanizëm, arsim, ekonomi, bujqësi, administratë, komunikacion, plane të infrastrukturës, etj.).

The Archive building was built in 1928, where during different historical periods it was used for different functions, such as state security station. The building was in private possession until 1947, then the state owned it.


The Historical Archive of the city of Ferizaj was established on 19.04.1980 by decision of the Municipal Assembly, but the work as a cultural unit started on 01.09.1980. There were a total of 199 municipality registrations.

Now the Historical Archive includes the city of Ferizaj with the district and operates within the Directorate for Culture, Youth and Sports. It contains 68 funds of various activities (urban planning, education, economy, agriculture, administration, communication, infrastructure plans, etc.).

Ndërtesa e Stacionit të Trenit u ndërtua në vitin 1873 pas përfundimit të punimeve në ndërtimin e vijës hekurudhore. Kjo është ndërtesa më e vjetër publike në qytet. Hekurudha ishte projektuar nga francezët të cilët kishin bërë edhe projekte të shumta në territoret e Perandorisë Osmane. Kjo hekurudhë pati rol shumë të rëndësishëm në formimin e qytetit të Ferizajt, i cili me kalimin e viteve u zgjerua duke u bërë vendbanim i madh. Hekurudha në popull njihet me emrin “udha e frëngut”. Gjithashtu, kjo hekurudhë evokon kujtime të shumta përgjatë ekzistencës së saj, duke bërë që shpesh herë të ishte vend i shumë ngjarjeve historike, duke nisur me depërtimin e qindra mijëra hebrenjve drejt kampeve të përqendrimit nazist, përgjatë Luftës së Dytë Botërore. Gjithashtu, në kujtesën tonë kolektive mbetet ende i freskët kujtimi për dëbimin e qindra mijëra shqiptarëve të Kosovës, si pasojë e dhunës dhe gjenocidit serb të ushtruar kundër popullit shqiptar përgjatë viteve të luftës në Kosovë (1998-99).

NDËRTESA E STACIONIT TË TRENIT

TRAIN STATION BUILDING



The Train Station building was built in 1873 after the completion of the works on the construction of the railway line. This is the oldest public building in the city. The railway was designed by the French who had also done numerous projects in the territories of the Ottoman Empire. This railway had a very important role in the formation of the city of Ferizaj which, over the years, expanded to become a large settlement. The railway was popularly known as “Udha e frengut”. Also, this railway evokes many memories throughout its existence, making it often the protagonist of many historical events, starting with the deportation of hundreds of thousands of Jews to Nazi concentration camps, during the years of the Second World War. Also, we remember the of the expulsion of hundreds of thousands of Kosovo Albanians, as a result of the Serbian violence and genocide perpetrated against the Albanian people during the war in Kosovo (1998-99).

Mulliri i Nikës gjendet në perëndim të qytetit të Ferizajt, në afërsi me fenomenin natyror të Bifurkacionit të Lumit Neredime. Në Ferizaj, tradicionalisht kishte shumë mullinj të ujit, ku vetëm në lumin Neredime ishin gjithsej 52 të tillë. Ndër mullinjtë më të njohur, i ndodhur pak metra larg fenomenit të Bifurkacionit, është Mulliri i Nikës. Mendohet të jetë ndërtuar në kohën e sundimit osman, në shekullin XVII. Rrugëtimi i këtij mulliri nëpër kohë ishte karakterizuar me shumë sfida. Duke parë se kishte filluar që arkitektura e këtij mulliri të degradohej nga pesha e rëndë e shekujve, atëherë u pa si nevojë e domosdoshme të përmiresohet gjendja e tij, dhe në vitin 2003 u rindërtua, duke synuar në ruajtjen e formës dhe dukjes që kishte.

Nika's Mill is located in the west of the city of Ferizaj, close to the bifurcation natural phenomenon of Neredime River. There were traditionally many water mills in Ferizaj, with a total of 52 of them on the Neredime river alone. Among the most popular mills is the Mill of Nika which is located a few meters away from the Bifurcation phenomenon. It is thought to have been built in the 17th century during the Ottoman rule. The journey of this mill through time has been characterized by many different challenges. Seeing that the architecture of this mill had begun to degrade from the heavy weight of centuries, intervention was considered as an imperative need. Thus, it was rebuilt in 2003, having been preserved its shape and appearance.

MULLIRI I NIKËS

NIKA'S MILL





Është ndërtuar gjatë viteve të 70-ta të shekullit XVIII-të, dhe ishte mulliri më i njohur në trevën e Ferizajt dhe më gjerë. Ky mulli kishte në funksion gjashtë gurë të cilët lëviznin me ndihmën e turbinës e cila merrte fuqinë e nisjes nga lugu i mbushur me ujë për të mundësuar lëvizjen e gurëve dhe përgatitjen e miellit, që përfitohej nga bluarja e misrit. Ka pasur shumë njerëz nga trevat e ndryshme të Kosovës të cilët kanë pritur në shumë raste nga dy deri në tri ditë për bërë bluarjen e misrit. Për këtë arsye, në hapësirën e mullirit ekzistonte edhe konaku ose dhoma e pritjes së mysafirëve.

It was built during the 70s of the 18th centuries, and it was the most famous mill in the Ferizaj area and beyond. This mill had six operating stones that moved with the help of a turbine which took the starting power from the trough filled with water and then triggered the movement of the stones and the preparation of the flour obtained from the corn grinding. There were many people from different regions of Kosovo who, many times, waited from two to three days to grind the corn. For this reason, there was also a guest house or a guest room nearby the mill to accommodate the guests.



MULLIRI I MADH

THE GREAT MILL



MULLIRI NË NERODIME TË EPËRME THE MILL IN NERODIME TË EPËRME

Mulliri në Neredime të Epërme i përket shekullit XX-të, i cili është funksional dhe mundëson bluarjen e misrit. Ndër vite, forma e mullirit ka pësuar ndryshime, është zvogëluar paksa dhe është përshtatur që të punoj vetëm më dy gurë të cilët ndihmojnë në bluarjen e misrit.

The mill in Neredime te Eperme (Upper Neredime) belongs to the 20th century, which is functional and enables the grinding of corn. Over the years, the shape of the mill has undergone changes, it has been slightly reduced and adapted to work with only two stones that help grind corn.

MULLIRI I SELMAN BEGËS

SELMAN BEGA'S MILL

I takon vargut të gjatë mullinjve të ujit që ishin në rrjedhën e Lumit të Madh dhe atij të Neredimes. Ky mulli gjen det në fshatin Jezerc i cili ishte mjaft i pasur me këtë trashëgimi kulturore që ndërlidhej me industrinë e blojës. Andaj, ky mulli i takon fillim shekullit XX-të, po ashtu ka pasur ndërhyrje për t'i zgatur jetën në disa periudha. Kurse më 2012 është rindërtuar, ku brenda tij gjendet vetëm një guri që është përdorur për bluarje të misrit.



